

OSHEE GROUP sh.a njofton mbi hapjen e vendit vakant **Shef Dege** pranë OSSH / Drejtori Rajonale / Dega Teknike.

SHEF DEGE

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Përgjegjës për koordinimin dhe drejtimin e punës në Degën Teknike.
- Përgjegjës për vazhdimësinë e punës dhe aktivitetëve të menaxhimit të rrjetit.
- Përgjegjës për sigurimin e një shpërndarje cilësore dhe në kohë të energjisë elektrike nëpërmjet rrjetit elektrik tek konsumatorët.
- Përgjegjës për përcaktimin dhe zbatimin e një strategjie të përgjithshme mbi rrjetin elektrik.
- Përgjegjës për realizimin e planit të investimeve në kohë dhe brenda buxhetit.
- Raporton për progresin e realizimit të planit të investimeve.
- Përcakton planet afatgjata të zhvillimit të rrjetit dhe bën parashikime të buxhetit.
- Krijon planet dhe buxhetet vjetore për investime, meremetime të mëdha dhe mirëmbajtje.
- Analizon funksionimin e rrjetit dhe vlerëson gjendjen mekanike të tij për krijim të strategjive të mëvonshme.
- Menaxhon operacionet dhe aktivitetet e mirëmbajtjes në rrjetin e shpërndarjes së TM/TU.
- Përgjegjës për sigurimin e një shpërndarje cilësore dhe në kohë të energjisë elektrike nëpërmjet rrjetit elektrik të TM/TU.
- Koordinon e menaxhon mirëmbajtjen, riparimet dhe funksionet operative në rajonin e dhënë për të siguruar me cilësi, me kohë dhe siguri shpërndarjen e energjisë elektrike të konsumatorëve.
- Përgjegjës për zbatimin e programit vjetor të mirëmbajtjes.
- Aktivitete të tjera, të ngarkuara nga Eprori i drejtpërdrejtë.

Kualifikimet dhe kërkesat:

- Të ketë përfunduar Fakultetin e Inxhinierisë Elektrike me rezultate të mira.
- Të ketë eksperiencë pune mbi 3 vjet.
- Të ketë njohuri për programet bazë të kompjuterit.
- Të njohë gjuhë të huaja, preferohet gjuha angleze.
- Aftësi shumë të mira komunikuese edhe punës në grup.

Të gjithë kandidatët e interesuar janë të lutur të bëjnë aplikimin në websiten e OSHEE group, në portalin e punësimit.

Ju njoftojmë se vetëm kandidatët e përzgjedhur do të ftohen për intervistë.